



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

### **RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

| Eksperti Shqyrtues   | Data e autorizimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës     |
|----------------------|---------------------------------|------------------------------|------------------|
| <b>Flori Rexhepi</b> | <b>27.11.2023</b>               | <b>11.12.2023</b>            | <b>2023/0925</b> |

#### **BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT**

Me datën: 20.11.2023, OE “DESHISHKU GB SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0925, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Luigj Kastrati B.I”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Intervenimet Emergjente Ritenderim (10,000.00 per vitin 2023, 10,000.00 per vitin 2024, 10,000.00 per vitin 2025)” me nr. të prokurimit: "611-23-11243-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA GLLOGOC.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë te hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 30,000.00 €.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 17.10.2023; data e hapjes së ofertës: 26.10.2023; data e njoftimit mbi vendimin e AK-se: 03.11.2023; data e njoftimit me letër standarde: 03.11.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

#### **DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE**

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi dhe Transparenca

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

## KRITERET PËR VLERËSIM

**Kërkesat e përshtatshmërisë:** *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

|                                          |           |                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|------------------------------------------|-----------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                          |           | 1. Kërkesat përshtatshmerisë Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik Ligjit Nr. 04 L- 042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092, përkatësisht Nenit 65 pika 1,2,3,4, 4.9 dhe 5. | 1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Ligji mbi Prokurimin Publik Ligjit Nr. 04 L- 042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237 ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092, siç është cekur në Pjesën, do të dorëzohen në formë Aneksit të gjithë pjesëmarrësit - origjinal |
|                                          |           | 2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit                                                                                                                                                                                                        | 2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit tenderit (vetëm per OE fitues) - kopje.                                                                                               |
|                                          |           | 3.Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente – ekonomike                                                                                                                                                                                                                          | 3. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente ekonomike apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit (vetëm per OE fitues) origjinal apo e noterizuar                                                                                                                                                                                                 |
| Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale | 7.1 & 7.2 | <b>Përshtatshmëria profesionale:</b><br><br>1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit)                          | <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i><br><br>1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit)                                                                                                                      |
|                                          |           | 2. Kopja e numrit fiskal                                                                                                                                                                                                                                                             | 2.Kopja e numrit fiskal - kopje                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |

|                                                     |           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|-----------------------------------------------------|-----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare      | 8.1 & 8.2 | <b>Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</b><br><br><b>N A</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i><br><br><b>N A</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale | 9.1 & 9.2 | <b>Kapaciteti teknik dhe profesional:</b><br><br><b>1. Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional. Stafi i mesëm që do të kyqet në projekt – minimum 5 punonjës , Menaxheri i projektit të jetë ingjinier apo bachelor i Ndërtimtarisë- Drejtimi Konstruktiv me diplomë i caktuar me një vendim, CVI-ja</b> | <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i><br><br><b>1. Lista e stafit - Original Për të gjitha kërkimet rreth stafit duhet të ofrohen dëshmitë në kopje, stafin profesional (inxhinierin) kontrata marrëveshja paraprake për angazhimin e Tijë këtë projekt, kopja e Diplomës , CVI-ja - kopje Për stafin e mesëm kontratat -kopje.</b>                           |
|                                                     |           | <b>2. Të paraqitën paisjet raportet për mjetet – stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Paisje te domosdoshme) pompa ose autocisterna , një lug ngarkuese , një bager , një kamion me kapacitet minimumin 8-10 ton</b>                                                                                                                                                                                                           | <b>2. Lista e paisjeve - Original për të gjitha kërkimet rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje dhe dëshmi (kopjet e librezave , fatura, DUD-i etj, kompania i ka ne pronësi ose kontratë të shfrytëzimit e tyre (qera).</b>                                                                                                                      |
|                                                     |           | <b>3.Të paraqitën kontratat e punëve të ngjajshme në tri vitet e fundit nga data e Publikimit te Njoftimit per Kontrat min. 30,000.00 €</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | <b>3.Lista e Kontratave- origjinale - të natyrës ngjajshme , kopje te kontratave te bashkangjitur me( raportet e pranimeve ose proceseve pranimeve ose referencave-Njeren prej tyre) në tri vitet e fundit, ku identifikohet qarte, shuma, numri i kontratave, viti, titulli etj) , institucioneve publike ose proceset e pranimeve nga personat privat.</b> |

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues është i përgjegjshëm

OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm

## INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

#### VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

#### VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

#### ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

#### PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **DESHISHKU GB SH.P.K.**

##### **Sqarim**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontaktues – Komuna Glogoc , nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, kryesisht nenin 59 të LPP-se, me këtë rast ka rekomanduar për kontrate një operatore ekonomik i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes se tenderit.

Autoriteti Kontaktues – Komuna Glogoc, me datën 08.11.2023 ka publikuar njoftimin B46 - Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm.

OE ankues DESHISHKU GB SH.P.K me datën: 03.11.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim ndërsa AK-ja me datën 09.11.2023 refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ankues si të pabazuar.

##### **Pretendimi nr.1**

Autoriteti Kontraktues: Komuna Glogoc, me datë: 03.11.2023, ka shpërblyer me kontratë OE: Luigj Kastrati B.I., për tenderin me titull: Intervenimet Emergjente / Ritenderim (10,000.00 për vitin 2023, 10,000.00 për vitin 2024, 10,000.00 për vitin 2025); Me numër të prokurimit: 611-23-11243-2-2-1. Me datë: 08.11.2023 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim te AK, por të njëjtit e kanë cilësuar të pa bazë kërkesën tonë, në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim të datës: 09.11.2023 i kanë shtuar dhe ndryshuar arsyet e eliminimit nga vendimi i datës: 03.11.2023. Arsyeja e eliminimit nga AK, në vendimin e datës: 03.11.2023, kanë qenë: I mungojnë referenca dhe kontratat e natyrës së ngjashme.

Ne vijim ju paraqesim kontratat e ngjajshme dhe shume te përafërta me aktivitetin e prokurimit ne

fjale:

*Punëdhënësi: Kompania Regjionale e Mbeturinave Uniteti Sh.A; Titulli i kontratës: Mbulimi i deponise; Vlera e kontratës: **17.152,00 Euro** (Ne këtë aktivitet të prokurimit kemi bere grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të ndryshme si dhe mbulimin e tyre si mbas kërkesave të shpejta të AK, po ashtu kemi bere transportin e kafshëve, gruposjen dhe mbulimin e tyre mbrenda deponise se licencuar).*

*Punëdhënësi: Kompania Regjionale e Mbeturinave Uniteti Sh.A; Titulli i kontratës: Mbulimi i deponise; Vlera e kontratës: **43.200,00 Euro** (Ne këtë aktivitet të prokurimit kemi bere grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të ndryshme si dhe mbulimin e tyre si mbas kërkesave të shpejta të AK, po ashtu kemi bere transportin e kafshëve, gruposjen dhe mbulimin e tyre brenda deponise se licencuar).*

*Punëdhënësi: Komuna Skenderaj; Titulli i kontratës: Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve nëpër Bashkësi lokale Runik, Klinë, Likoc, Rezallë dhe Turçec në Komunën e Skenderajit; Vlera e kontratës: **185.000,00 Euro**.*

Ndërsa në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, AK i ka ndryshuar dhe shtuar arsyet e eliminimit, ne vijim ju paraqesim arsyet e eliminimit nga përgjigja në fjalë:

1. Ju mungojnë kontratat e natyrës së ngjajshme sipas DT dhe Njoftimit për kontratë, përkatësisht natyrës lidhur me dizenfektim.

2. Dhe ju mungon te pajisjet - Pompa për dizenfektim.

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja në dosje të tenderit në piken 9.1 & 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka kërkuar që:

**3.Të paraqitën kontratat e punëve të ngjajshme në tri vitet e fundit nga dita e Publikimit të Njoftimit per Kontrat min. 30,000.00 €**

**3.Lista e Kontratave- origjinale - të natyrës së ngjajshme , kopje të kontratave të bashkangjitura me( raportet e pranimeve ose proceseve të pranimeve ose referencave-Njeren prej tyre) në 3 vitet e fundit, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj) , institucioneve publike ose proceset e pranimeve nga personat privat.**

AK-Komuna Glogoc, pas përfundimit të vlerësimit e ka njoftuar OE ankues me letrën standarde të tenderuesit të eliminuar, të cilin e ka eliminuar me arsyetimin se i mungojnë referencat dhe kontrata të natyrës së ngjajshme.

**B42 - Letër standarde për [tenderuesin] [kandidatin] e eliminuar <sup>1</sup>**

[03.11.2023 DRENAS]

[ZYRA PROKURIMIT, DRENAS]

Titulli i kontratës: Intervenimet Emergjente Ritenderim (10,000.00 per vitin 2023, 10,000.00 per vitin 2024, 10,000.00 per vitin 2025)

|                          |
|--------------------------|
| <b>Nr. i Prokurimit:</b> |
| 611-23-11243-2-2-1       |

| Nr. | Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës |
|-----|--------------------------------------------------|
| 1.  | DESHISHKU GB SH.P.K.                             |

I/e nderuar(a) [Z/Znj]

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”. [Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në [dosjen e tenderit] [dokumentet parakualifikuese]. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim: [Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është administrativisht i papërgjegjshëm: ARSYETIM

[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :  
[Deklaroni arsyet e hollësishme mbi refuzimin në përputhje me rrethanat]

**1. I mungojn referencat dhe kontrata të natyres se ngjajëshme**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt

(GEZIM HAJDINI)

(Nënshkrimi)

Eksperti shqyrtues pas analizimit të dokumentacionit, konkretisht ofertës së OE ankues sqaron se i njëjti ka dorëzuar listën e kontratave me përshkrim të titujve të kontratave për të cilat eksperti shqyrtues vlerëson se e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit lidhur me natyrën e kontratës, për faktin se vet titulli i aktivitetit “Intervenimet emergjente”, përfshin një natyrë të gjere të punës (Pastrimin e pusetave – kanalizimeve, transportin e kafshëve apo mbeturinave vendosja e gypave etj), për të cilat OE ankues ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

OE ankues ne ankesën e tij pretendon se AK-ja, ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se, ka vepruar me rastin e përgjigjes ne kërkesën për rishqyrtim me arsyetimin se ka shtuar arsye tjera të eliminimit.

Ky pretendim i OE ankues qëndron dhe njëherit eksperti shqyrtues e kualifikon si shkelje procedurale nga ana e AK-se, sepse me këtë rast është shkelur nenit 108/A i LPP-se, sepse OE ankues nuk ka pasur mundësin të apeloj ne shkallen e pare e arsyet e eliminimit (te gjetura e reja) për të cilat pretendon AK-ja. Prandaj, eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja, nuk ka të drejtë të shtojë arsye tjera pa i dhënë mundësi OE qe ti kundërshtojë ne shkallen e pare.

I rekomandoj AK-se qe ne raste te tilla duhet te aprovoje kërkesën për rishqyrtim te operatorit ekonomik dhe aktivitetin e prokurimit ta kthej ne rivlerësim, ne mënyrë qe me pas një operator ekonomik pas pranimit te letrës standarde te ketë mundësi ti kundërshtoj nëse shpreh interes.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtuar nga OE “**DESHISHKU GB SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Intervenimet Emergjente Ritenderim (10,000.00 per vitin 2023, 10,000.00 per vitin 2024, 10,000.00 per vitin 2025)**” me numër të prokurimit: “**611-23-11243-2-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA GLLOGOC**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA GLLOGOC**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **DESHISHKU GB SH.P.K.**

**Florije Rexhepi**

